



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PUKË
KËSHILLI BASHKIAK

Nr.664/2 prot

Puke, me 18.04.2025

V E N D I M
Nr.12 datë 18.04.2025

“PËR MIRATIMIN E SHITJES ME ANKAND TË AKSIONEVE TË KLUBIT TË FUTBOLLIT ”FK TËRBUNI”SHA ME NIPT L19704301F NË MASËN 100%”

Mbeshtetur në nenin 113,pika 2 të ligjit nr.8417, datë 21.10.1998”Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”të ndryshuar ,nenit 8,pika 2,neni 9 pika 1,nënpika 1.1 shkronja “b”,nën pika 1.2 ,shkronja “a”,nenit 54 gërma”e” të ligjit nr.139/2015, date 17.12.2015 “Per Vetëqeverisje Vendore”i ndryshuar, ligjit nr.9901 ,datë 14.04.2008 “Për tragtarët dhe shoqëritë tregtare”të ndryshuar ,Ligjin nr.105/2020 “Per disa shtesa dhe ndryshime ne ligjin nr.79/2017“Për Sportin”,Ligjit nr.9874 ,dt.14.02.2008”Për ankandin publik” i ndryshuar ,themeluar si Shoqeri Aksionere me datë 14.10.2011 ,me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak, pas shqyrtimit në përfundim ;

VENDOSI:

1. Miratimin për shitjen me Ankand në masen 100% të aksioneve që Bashkia Pukë zotëron si aksionere e vetme në Shoqërine Klub Futboll “Tërbuni”sh.a
 2. Çmimi minimal i shitjes së 100% të kuatave është 5,200,000 (pesëmilion e dyqindëmijë) lekë sipas raportit bashkangjitur .
 3. Forma e shitjes së aksioneve, që zotërohen nga Bashkia Pukë në Shoqërinë Klub Futboll Tërbuni të bëhet nepërmjet procedurës konkurruese, Procedure e Hapur Standart e Ankandit.
 4. Procedura e ankandit për shitjen e 100% të aksioneve që zotëron Bashkia Pukë të nise me vleren 5,200,000 (pesëmilion e dyqindëmijë) lekë.
 5. Për e zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë Pukë.
 6. Ky vendim hyn në fuqi sipas ligjit Nr. 139, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen Vendore”
 7. Vendimi u shpall me date 18.04.2025.
- Vota te vlefshme gjithsej : 9
Vota pro 9 , vota kunder 0 , vota abstenim 0

SEKRETARI

Hazbi Terbuni

KRYETARI

Gjon GJOKA

